

Anglisht në shkollën fillore

Informacion për prindër



Redaksia: **Zentralschweizer Projektgruppe Englisch Primarschule:**

Pia Ettlin, NW

Anna Häfliger, OW

Peach Richmond, LU

Andrea Zeiger, ZG

Nathalie Zraggen, UR

Monika Mettler, Projektleitung

Copyright: © Bildungsplanung Zentralschweiz, Mai 2005

Grafika: Atelier für Graphik, Karin Willimann, Luzern

Ilustrimet: Seite 4, 11: Mit freundlicher Genehmigung aus «Here Comes Super Bus»
Level 3; Macmillan Publishers Ltd., Oxford

Seite 3, 7, 8, 12, 15: Mit freundlicher Genehmigung aus «Young World»

English Class 3, Activity Book; Klett und Balmer Verlag, Zug

Shtypi: Eicher Druck AG, Horw

Botimi 1.: 15'000 Exemplare

Përmbajtja

Parafjalë për prindër **Faqe 3**

Synimi i qëllimeve **Faqe 4**

*Mësimi i gjuhëve duke i përdorur ato
Të kuptuarit në të folur e të shkruar
Gjuhët e reja hapin botëra të reja
Hapjet e rrugëve (mundësive)*

Anglisht nga klasa e 3-të **Faqe 6**

*Një shikim në Evropë
Çfarë thotë shkenca
Më shumë kohë
Bazë për mësim të mëvonshëm*

Mësimi **Faqe 8**

*Përshtatur moshës
Në anglisht, ju lutem!
Mësim, mësim
Shkallët në procesin mësimor
Përmbajtjet dhe materialet mësimore*

Të gabuarit, mësimi i fjalëve, përdorimi i rregullave gramatikor **Faqe 10**

*Si dhe kur të korrigohet?
Gramatika
Mësimi i fjalëve*

Asgjë s'është më i suksesëshëm se sukcesi! **Faqe 12**

*Përkrahja dhe shfrytëzimi i aftësisë
Forcimi i dëshirës dhe interesimit për gjuhën
Tregimi i besimit në aftësitë për të mësuar dhe kurajimi për përdorim
Marrja e përgjegjësisë për të mësuarit e vet
Dhe të tregohet çka është mësuar*

Përkrahja nga ana e prindërve **Faqe 14**

Të dashur prindër

Fëmija i juaj mëson nga klasa e tretë anglisht. Ju për këtë keni sigurisht disa pyetje dhe ndoshta dëshironi të dini si ju gjatë mësimit mund të përkrahni fëmijën tuaj.

Kjo broshurë ju shërben juve si ndihmë orientuese dhe sqaron pyetjet e rëndësishme. Ne deshirojm të ju udhëzojm për arsyet dhe qëllimet e mësimit të gjuhëve të huaja sot dhe të ju këshillojm se si ju mund të përkrahni fëmijën tuaj përgjatë rrugës së mësimit të suksesëshem. Me këtë sigurisht se nuk mund të sqarohen plotësisht të gjitha paqartësitë. Mësimdhënësi i djalit apo vajzes tuaj me dëshirë do të ju ndihmojn më tutje.



Synimi i qëllimeve

Fillimit të hershem të mësimit të gjuhëve të huaja i takon përveq kompetencave gjuhësore edhe zhvillimi i vetëdijes për gjuhën dhe kompetencën e mësimit.

Mësimi i gjuhëve duke i përdorur ato

Qëllimi i mësimit modern të gjuhës së huaj është që nxënëset dhe nxënësit të përgaditen që në lojë dhe në situatat reale të përdorin anglishten dhe të kontaktojnë në anglisht. Kështu zhvillohet një lidhje e gjallë me gjuhën. Nuk është pra primare që fjalët dhe rregullat gramatikore të mësohen të izoluara, shumë më shumë nxënëset dhe nxënësit duhet me shembuj konkret nga përditshmëria dhe nga lëmitë që ju interesojnë atyre të mësojnë anglisht.

Të kuptuarit në të folur e të shkruar

Mundësia për të kuptuar në një gjuhë të huaj qoftë edhe shumë thjesht në fillim, ndikon te fëmijët duke i motivuar dhe duke i pasuruar ata. Që në fillim të mësimit anglisht vihen bazat për komunikim në përditshmëri. Qëllimet konkrete të mësimit të gjuhës janë të shkruara në planprogramin mësimor regional. (krahaso. www.zebis.ch)



Gjuhët e reja hapin botëra të reja

Mësimi i gjuhës angleze ndihmon gjithashtu njohjen e kulturave në vendet ku flitet anglishtja, dhe ndihmon hapjen dhe tolerancën për të panjohuren dhe të huajen.

**«Mësimi i gjuhëve ka përgjithësisht
pasojë pozitive në zhvillimin e aftësive
intelektuale.»**

*Dr. Willi Stadelmann,
Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zvicëres Qendrore*

Hapjet e rrugëve (mundësive)

Mësimi i hershem i anglishtes luan rol të rëndësishëm edhe për mësim të mëvonshëm, në të cilin mund të bazohet qëndrimi pozitiv dhe nxitja e mësimin të gjuhëve përgjithësisht në veqanti të gjuhës angleze.

Anglisht nga klasa e 3-të

Sa herët duhet të fillohet me mësim të gjuhëve të huaja? Me këtë pyetje ka kohë që merren në gjithë Evropën gjuhëtarët dhe pedagogët, por edhe politikanet për arsim, trupi pedagogjik dhe natyrisht edhe prindërit. Për ta thenë që në fillim: NJË përgjegjëje të vetme nuk mund të ketë sepse për mësim të suksesëshem të gjuhëve mosha hyrëse (startuese) është vetëm një prej faktorëve të rëndësishem.

Një shikim në Evropë

Një krahasim me vendet tjera evropiane tregon se tendenca për mësim të hershem të anglishtes shtohet pandalshem. Edhe në Zvicër shumë prindër ka kohë që i dërgojn fëmijët e tyre në shkolla private.

Çfarë thotë shkenca?

Nga kërkimet shkencore dihet se fillimi me një gjuhë të huaj në moshën e re fëmijërore është veqanërisht i suksesëshem sepse truri tregon një elasticitet i cili më vonë si i tillë nuk ekziston më. Fëmijët në moshën e re kanë përparësi veqanërisht në kuptimin fonetik si dhe mësimin e shqiptimit.

**«Truri i fëmijëve të vegjel
dalohet për kapacitet të pashtershëm.»**

*Dr. Willi Stadelmann,
Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zvicëres Qendrore*


Përveq kësaj fëmijët e moshës së re tregojn një interesim natyror, gëzim dhe kureshtje për gjuhët e huaja. Ata nuk frikësohen dhe mësojnë me dëshirë duke lozur dhe imituar. Këto përparësi të mira mundet t'i shfrytëzoj programi mësimor i gjuhëve të huaja.

Më shumë kohë

Një arsye më shumë për mësim të hershem të gjuhëve është edhe shiqimi i shtimit të rëndësisë së kompetencave të gjuhëve të huaja. Për rininë e sotit njohuritë e gjuhëve të huaja janë më të rëndësishme për avancim profesional se sa që ishin për gjeneratat e mëparshme. Nëse të gjitha nxënëset dhe të gjithë nxënësit deri në fund të shkollimit obligativ duhet të arrijn kompetenca më të mira të gjuhëve të huaja, duhet thjesht edhe një kohë më e gjatë e mësimi.

Bazë për mësim të mëvonshëm

Mësimi i hershem i një gjuhe të huaj të parë vendos bazat e rëndësishme për mësim të gjuhëve tjera gjatë shkollimit përveq kësaj edhe për gjithë jetën. Kush bën herët përvoja pozitive më mësim të gjuhëve të huaja, mëson më lehtë më vonë. Dhe themelet gjuhësore shërbejnë si bazë, mbi të cilat mund të nisët mësimi i gjuhëve të mëtutjeshme.



Mësimi

Përshtatur moshës

Sikurse i gjithë mësimi tjetër edhe mësimi i gjuhës angleze i është përshtatur moshës së fëmijëve të kësaj shkalle (klase). Mësimi strukturohet në forma të shumëllojshme dhe interesante. Mësimi është i orientuar në veprime e përjetime dhe u jep njohuri fëmijëve për përmbajtjet rreth interesimeve në moshën e tyre si dhe për temat kulturore, të cilat bëhen të mundura për rrethin e përjetimeve të fëmijëve.

Në anglisht, ju lutem!

Në mënyrë që nxënëset dhe nxënësit të ambientohen (mësohen) me gjuhen, mësimi zhvillohet në gjuhen angleze. Kur është nevoja mësimdhënësi ofron ndihmë me fotografi dhe gjeeste për të lehtësuar të kuptuarit (komunikimin).

Gjuha e re do të përdoret edhe në situatat e vërteta komunikative të përditëshmërisë shkollore. «Plese, close your books!» ose «it's time for lunch now» ka një ndërlidhje reale me ndodhitë në klasë dhe është e vetëkuptueshme se do të thuhet në anglisht.

Mësim, mësim

Një qëllim i rëndësishëm i mësimit është vetëdijësimi dhe zhvillimi i strategjive mësimore. Fëmijët mësojnë se si mësohet më së miri dhe më së suksesi një gjuhë e huaj, si mësohen p.sh. fjalët ose si mund të ndihmojnë vehten kur nuk kuptojnë diçka.



Shkallët në procesin mësimor

Fëmijët gjatë mësimit të gjuhës së huaj kalojnë nëpër shkallë të ndryshme. Zakonisht ata kuptojnë diçka në gjuhën e huaj para se vet në mënyrë aktive mund të artikulojnë me gojë apo shkrim. Ky është një proces normal, i cili zhvillohet në gjuhën e parë, të ashtuquajtur gjuhë amtare, të kuptuarit para të folurit.

Përmbajtjet dhe Materialet mësimore

Materialet mësimore do duhej të mundësojnë një mësim interesant e me qëllim të qartë, i cili do përkrah dëshirën (interesimin) për gjuhën angleze. Përshtatur moshës do të shtohen kërkesat dhe kompleksiteti i përmbajtjeve, kjo do të ndihmojë që të mos bie kureshtja dhe gadishmëria e fëmijëve për të mësuar gjuhën. Në procesin mësimor të gjuhës

«Domosdoshmëri është përdorimi i didaktikës gjuhësore që i përshtatet moshës: Fëmijët e vegjël mësojnë ndryshe nga të rinjtë e të rejtat apo të rriturit.»

*Dr. Willi Stadelmann,
Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zvicërës Qendrore*

angleze fëmijët nuk mësojnë vetëm gjuhën por përmes gjuhës mësojnë edhe për qështje tjera, p.sh. për format e banimit në vende të ndryshme ose për fenomenet e motit dhe klimës ose për ndonjë artist të kohës.

Të gabuarit, mësimi i fjalëve, përdorimi i rregullave gramatikore

Fëmija i juaj është në një proces të vazhdueshëm të mëimit të gjuhës. Të gabuarit është krejt normal. Nga gabimet mëson njeriu, ato janë pjesë e procesit të mëimit të gjuhës, kjo vlen si për gjuhën e parë (amtare) ashtu edhe për gjuhët e huaja. Çdo gabim bën njeriun pak më të menqur madje mundet të vetëdijësoj për ndonjë fenomen të caktuar gjuhësor.

Si dhe kur të korrigohet?

Natyrisht se do të korrigojen gabimet por jo gjithëherë dhe të gjitha. Kjo mvaret nga detyra e shtruar. Në një situatë gojore një korrigjim i përhershëm pengon qëllimin e të folurit. Kur është fjala më tepër për përmbajtjen, të shkruarit apo të folurit korrekt është sekondar. Herën tjetër në qendër të vëmendjes është p.sh. përdorimi korrekt i vetës së tretë në njëjs, me ç'rast shkrimit korrekt të foljes i kushtohet rëndësi.

**«Gjuhët janë instrumente të rëndësishme
interpretuese të trurit dhe katalizator të rëndësishëm
për të mësuar.»**

*Dr. Willi Stadelmann,
Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zvicëres Qendrore*

Gramatika

Vetëm me rregullat gramatikore fëmija i juaj nuk do të mund të mësoj përdorim aktiv të gjuhës. Nuk është e domosdoshme zotësia e rregullave gramatikore për të përdorur gjuhën. Ju kujtohet se si fëmija i juaj me sukses ka mësuar gjuhën e parë (amtare)? Gramatiken e mëson njeriu duke e përdorur gjuhën. Ajo rrjedh vazhdimisht në procesin mësimor.

Fëmija i juaj kalon nëpër faza të ndryshme të kuptimit gramatikor.



Dhe pasi që të ketë arritur një shkallë të caktuar ka kuptim korrigjimi. Këtu vlen principi i tolerances së gabimeve. Njëanëshmëria ose koncentrimi i tepruar në formulimet korrekte gramatikore pengon (frenon) guximin dhe dëshirën për mësim dhe përdorimin e gjuhës.

Mësimi i fjalëve

Fëmija i juaj gjatë procesit mësimor të gjuhës së huaj do të ndeshet me ndërlidhjen përmbajtësore dhe nga kjo ndërlidhje mëson kuptimin. Pra nuk është kuptimplotë mësimi i izoluar i fjalëve. Nëse dëshironi të përkrahni fëmijën tuaj gjatë mëimit të fjalëve përdorni fjalë me sa më tepër ndërlidhje përmbajtësore.

Asgjë s'është më i suksesëshem se sukcesi!

Kjo fjalë e urtë është e saktë edhe për mësimin e gjuhëve të huaja. Megjithatë: Çka e bën thelbin e suksesit?

Përkrahja dhe shfrytëzimi i aftësisë

Natyrisht se ka, sikurse në të gjitha lëndet tjera shkollore, fëmijë të cilët tregojn më shumë ose më pak aftësi, të cilët tregojn më shumë ose më pak «zjarr të brendshëm» (entuziazëm) për një gjuhë të huaj. Megjithatë: edhe talenti më i madh mbetet i pa shfrytëzuar nëse motivacioni dhe dëshira për mësim nuk përkrahen. Kshtuqë edhe një nxënës me talent më të vogël por me dëshirë dhe përkrahje të madhe për mësim mund të ketë sukses.

Forcimi i dëshirës dhe interesimit për gjuhën

Kënaqësia për gjuhën dhe interesimi për ta mësuar atë janë faktorët kryesor ndikues. Fëmijët më moshën e re shkollore kanë përgjithësisht një interesim të madh për gjuhët dhe posaqërisht për anglisht sepse me këtë gjuhë ndeshen shpesh çdo ditë, p.sh. në muzik, reklamë dhe sport.



Tregimi i besimit në aftësitë për të mësuar dhe kurajimi për përdorim

Me rëndësi është të tregohet besim në aftësitë e nxënësve, të kurajohen ata për të përdorur atë që kanë mësuar pa pasur frikë nga gabimet.

«Përkrahja e hershme e fëmijëve duke ndërtuar strategjitë e mësimit krijon përparësinë për mësime gjatë gjithë jetës.»

*Dr. Willi Stadelmann,
Drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zvicrës Qendrore*

Marrja e përgjegjësisë për të mësuarit e vet

Sa më shumë bën një fëmijë mësimin e gjuhës së huaj qështje të vërtetë aq më dëshirë dhe interesim e mëson atë. Sepse p.sh. e vëren se atë që ka mësuar është e dobishme aq më tepër merr përgjegjësi për mësime.

Kështu pastaj fëmija nuk mëson vetëm për notën apo për mësime të mëtejshme.

Dhe të tregohet çka është mësuar

Nxënësit përjetojnë, çka kanë mësuar mund ta përdorin, ata zbulojnë dhe hulumtojnë gjuhën angleze. Orientimi në atë çka njeriu din e jo në atë çka nuk din sjellë ndjenjë kënaqësie. Dhe siq u tha: Asgjë nuk është më i suksesëshëm se sukcesi!

Përkrahja nga ana e prindërve

Ju mund të luani rol të rëndësishëm në përkrahjen e fëmijëve tuaj edhe nëse vet nuk e njifni gjuhën angleze.

Zgjoni në fëmijën tuaj...

vëmendjen për larmishmërinë e gjuhëve në përditëshmërinë tonë: në rrugë, në dyqane, në kiosk, në televizion, në media, reklamë.... kushtoni vëmendje këtyre gjuhëve. Diskutoni me fëmijën tuaj për shprehjet e huaja dhe kuptimin e tyre në gjuhën tonë. T-shirt (bluzë), skaten (rrëshqitje në rrugë), snowboarden (rrëshqitje në borë), Pizza (pica), Coiffeur, Trottoir (trotuar), Portemonnaie... (portofol) Tërheqni vëmendjen fëmijës për paralelet në mes fjalëve të ndryshme, luani me gjuhën.

«Pjesmarrja e prindërve krijon një rreth përkrahës dhe inkurajues edhe jashtë mësimit.»

*Christiane Blondin,
Fremdsprachen für die Kinder Europas*

Përdorni gjuhën e huaj...

lirëshem në përditëshmërinë tuaj, jepin fëmijës tuaj mundësinë të tregoj çka din por pa presion.

Tregoni fëmijës tuaj...

rrugët si mund të mësoj gjuhën e huaj.

Rrëfeni fëmijës tuaj...

tregime, shikoni së bashku libra me ilustrime. Merrni kohë t'i lexoni – në shqip! Fëmija juaj mëson kështu të kuptoj botën të artikuluar në gjuhë, fëmija ndërlihd ndodhitë e përditëshme dhe fantazitë imagji-

nuese, bën renditjen, luan me gjuhen. Nëse fëmijët ndihen të sigurtë në gjuhen amtare, mësojnë më lehtë një gjuhë të huaj.

Tregoni fëmijës tuaj...

një qëndrim pozitiv dhe interesim për të mësuar gjuhët. Detyrat e shtëpisë ju mundësojnë juve një pasqyrë të mirë për rrjedhën e mësimit. Por fëmija duhet t'i bëjë vet detyrat e shtëpisë.

Përforconi fëmijën tuaj...

në përpjekjet e tij dhe përkrahni dëshirën (gëzimin) e tij/saj për të mësuar gjuhët. Mësimi i gjuhëve duhet të jetë qështje vullneti, bërja e gabimeve është pjesë e procesit mësimor. Pra mos u përqendroni në gabime por tregoni besim në përparimin e fëmijës tuaj në mësim.

...dhe nëse keni qejf,

mësoni edhe ju bashkë me fëmijën. Ne ju dëshirojmë shumë kënaqësi dhe sukses.



Bibliografi

Blondin, Christiane et al. (1998). Fremdsprachen für die Kinder Europas. Ergebnisse und Empfehlungen der Forschung. Berlin: Cornelsen

Edelenbos, Peter; Kubanek Angelika (2001): Fremdsprachen lernen mit Spass – Wie Eltern ihre Kindern fördern können. Freiburg im Breisgau: Herder

Sarter, Heidemarie (1997). Fremdsprachenarbeit in der Grundschule. Neue Wege-Neue Ziele. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft

Stadelmann, Willi (2004): Sprachunterricht im Dienste der mehrsprachlichen Bildung: Sprachenlernen im Brennpunkt. In: i-mail. 3/2004, S. 4-7. www.ilz.ch

